



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Department

DATE	26.07.2023
REFERENCË	NV-137/2023
PËR/ZA/TO:	Z. Nuhî Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore

I nderuari z. Mani,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MEPT), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

#### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës që janë në fushëveprimin e Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: ATK), si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të ATK-në.

Dispozitat e këtij Ligji janë të obligueshme për të gjithë personat që i nënshtrohen fushëveprimit të këtij Ligji, për ATK-në dhe institucionet tjera të përcaktuara me këtë Ligj.

**OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E  
NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si organ propozues ka dërguar vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky projektligj për tu zbatuar ka kosto shtesë buxhetore në shumë prej 506,990 euro për vitet 2024-2025si dhe shtim të numrit të stafit për 15 pozita.

Kostoja totale për zbatimin e projektligjit për vitet 2023-2025 është në shumë prej 47,840,704 euro e shpërndarë nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve është si vijon:

Vitet	2023	2024	2025	Totali 2023-2025
Numri i punëtorëve	879	879	879	
Paga dhe Shtesa	8,024,226	8,237,721	8,639,682	24,901,629
Mallra dhe Shërbime	3,988,584	3,813,584	3,431,819	11,233,987
Shpenzime Komunale	361,696	361,696	361,696	1,085,088
Subvencione dhe transfere	40,000	40,000	40,000	120,000
Shpenzime Kapitale	4,100,000	3,200,000	3,200,000	10,500,000
<b>Totali</b>	<b>16,514,506</b>	<b>15,653,001</b>	<b>15,673,197</b>	<b>47,840,704</b>

Sipas Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 , ndarjet buxhetore për Administratën Tatimore të Kosovës për vitet 2023-2025 janë në shumë prej 47,33,714 euro të shpërndara nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve është si vijon:

Vitet	2023	2024	2025	Totali 2023-2025
Numri i punëtorëve	864	864	864	
Paga dhe Shtesa	8,024,226	8,039,226	8,441,187	24,504,639
Mallra dhe Shërbime	3,988,584	3,748,584	3,386,819	11,123,987
Shpenzime Komunale	361,696	361,696	361,696	1,085,088
Subvencione dhe transfere	40,000	40,000	40,000	120,000
Shpenzime Kapitale	4,100,000	3,200,000	3,200,000	10,500,000
<b>Totali</b>	<b>16,514,506</b>	<b>15,389,506</b>	<b>15,429,702</b>	<b>47,333,714</b>

Siç shihet nga tabelat e mësipërme ky projekt ligj krijon **kostoja shtesë buxhetore** mbi projeksionet buxhetore 2024-2025 të parapara me Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 në shumë prej 506,990 euro, për kategoritë e shpenzimeve dhe viteve si në vijim:

Vitet	2024	2025	Totali 2024-2025
Numri i punëtorëve	15	15	15
Paga dhe Shtesa	198,495	198,495	396,990
Mallra dhe Shërbime	65,000	45,000	110,000
<b>Totali</b>	<b>263,495</b>	<b>243,495</b>	<b>506,990</b>

Kostoja shtesë e këtij projektligji kryesisht ka të bëjë me themelimin e Bordit të Ankesave në kuadër të Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (neni 61) për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të nxjerra nga Njësia e Ankesave në ATK dhe Dogana e Kosovës (DK) lidhur me çështjet tatimore dhe doganore. Bordi përbëhet prej 15 anëtarëve dhe atë :

-një (1) kryesuesi dhe

-katëmbëdhjetë (14) anëtarëve, të cilët emërohen për një mandat prej katër (4) viteve, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat të dytë.

#### **Përfundim:**

Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, krijon kosto shtesë buxhetore në shumë prej 506,990 euro si dhe shtim të numrit të punëtorëve për 15 pozita, mjete dhe pozita të cilat nuk janë të parapara me Ligjin Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxheti e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025, kjo kosto shtesë buxhetore ka të bëjë me themelimin e Bordit të Ankesave që do të funksionoj në kuadër të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

Ndryshe, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara ta zbatojnë paragrafin 4, 5 dhe 7 të nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 ku thuhet:

4. Çdo nismë e re për shpenzime, përfshirë këtu legjislacionin e ri të propozuar, që nuk ka ndarje buxhetore të përfshirë në tabelat e bashkangjitura, nuk do të marrë ndarje buxhetore përveç nëse zbatohen shkurtime përkatëse në ndarjet e tjera buxhetore në vlerë të njëjtë.

5. Asnjë projektligj nuk mund të procedohet në Qeveri apo në Kuvend për aprovim nëse nuk ka të identifikuar burimin e financimit për vitin fiskal 2023 dhe vitet pasuese të parapara në projeksionet afatmesme të shpenzimeve buxhetore 2024-2025 të paraparë me nenin 5, paragrafi 1., dhe tabelat në kuadër të këtij ligji.

7. Nëse Qeveria aprovon një nismë të re që prodhon obligime buxhetore për një apo më shumë organizata buxhetore pas vitit fiskal 2023, atëherë ky obligim buxhetor me automatizëm trajtohet në përcaktimin e ndarjeve për këto Organizata Buxhetore në procesin e përgatitjes së buxhetit për vitin vijues.

Përgatitur nga:

Antigona Beckaj, Analiste e lartë e buxhetit

